




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

UDHËZUES PËR PËRFAQËSIM DHE PJESËMARRJE NË AKTIVITETE NDËRKOMBËTARE TË ZYRES KOMBËTARE TË AUDITIMIT

Prishtinë, prill 2025

Tabela e përmbajtjes

1. QËLLIMI.....	1
2. KRITERET PËR ANËTARËSIM	2
3. VENDIMI PËR ANËTARËSIM DHE TËRHEQJE	2
4. PËRFAQËSIMI	3
5. BUXHETI.....	5
6. NDIKIMI DHE NDRYSHIMI.....	5
7. PROCEDURA PËR REALIZIM DHE PJESEMARRJE NË AKTIVITETE NDERKOMBËTARE	6
8. NDRYSHIMI, RISHIKIMI DHE PLOTËSIMI.....	7
9. HYRJA NË FUQI.....	7
SHTOJCAT:	8

LISTA E SHKURTESAVE

AP	Auditori i Përgjithshëm
ECA	Gjykata Evropiane e Auditorëve
EUROSAI	Organizatës Evropiane të Institucioneve Supreme të Auditimit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
ISA	Institucione Supreme të Auditimit
ZKA	Zyra Kombëtare e Auditimit

1. QËLLIMI

Ky udhëzues ka për qëllim të përcaktojë procedurat dhe përgjegjësitë për pjesëmarrjen aktive të të punësuarve të ZKA-së në aktivitete të bashkëpunimit bilateral dhe multilateral me institucionet dhe organizatat ndërkombëtare të auditimit, përfshirë: Organizatën Ndërkombëtare për Institucionet Supreme të Auditimit (INTOSAI); Organizatën Evropian të Institucioneve Supreme të Auditimit (EUROSAI), Gjykatën Evropiane të Auditorëve (ECA), Institucionet Supreme të Auditimit (ISA), organizata tjera ndërkombëtare globale dhe regjionale si dhe grupe punuese apo task-forca dhe të tjera të lidhura me fushën e auditimit.

Përfaqësimi dhe pjesëmarrja sipas detyrës zyrtare në aktivitete ndërkombëtare është e një rëndësie të madhe për shkëmbimin e përvojave, zhvillimin profesional dhe avancimin e metodologjisë së auditimit. Kjo mund të realizohet duke qenë pjesëmarrës në aktivitete për përfaqësim zyrtar (konferenca, punëtori, seminare dhe të ngjashme), si anëtarë delegacionesh; pjesëmarrje në trupat punues të INTOSAI dhe EUROSAI; aktivitete të ndryshme ndërkombëtare; bisedime për marrëveshje; për marrjen dhe zhvillimin e njohurive nga ofruesit ndërkombëtarë; për të prezantuar të arriturat e ZKA-së në skenën ndërkombëtare; ngritjen e kapaciteteve të zyrtarëve të ZKA-së dhe pjesëmarrjes në trajnime të ndryshme.

Udhëzuesi parashih edhe mënyrën e përfaqësimit, vendimin dhe aprovimin e përfaqësimit dhe anëtarësisë, procesin e përzgjedhjes së përfaqësuesve, mënyrën organizative, mënyrën e financimit dhe raportimit si dhe përgjegjësitë e personave pjesëmarrës.

Sipas autorizimeve nga Auditori i Përgjithshëm, përmes këtij dokumenti ofrohen udhëzime të qarta, për veprimet, procedurat dhe kriteret e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit në trupat punuese të INTOSAI-t, EUROSAI-t apo mekanizmave tjerë ndërkombëtarë, të zyrtarëve të ZKA-së. Në rastet kur përfaqësimi vlerësohet i domosdoshëm, qoftë në takimet e rregullta vjetore, pjesëmarrje në konferenca, seminare etj, në nivel të përgjithshëm të bashkëpunimit ndërkombëtar, respektohen parimet e përgjithshme të këtij udhëzuesi.

Përfundimisht bëhet në rast të autorizimeve specifike nga AP.

Pjesëmarrësit në aktivitete janë të obliguar të respektojnë rregullat dhe standardet e brendshme të ZKA-së si dhe statutet dhe procedurat standarde të organizatave ndërkombëtare dhe regjionale. Po ashtu planet dhe qëllimet strategjike të këtyre organizatave duhet të jenë të njohura për pjesëmarrësit.

2. KRITERET PËR ANËTARËSIM

Me këtë udhëzues, ZKA-ja përcakton kriteret për anëtarësim në trupat punues duke marrë parasysh rëndësinë, burimet në dispozicion dhe fushat me interes për ZKA-në sipas planit strategjik dhe në pajtueshmëri me fushëveprimin. Gjithashtu, do të siguroj shmangien e angazhimit të njëkohshëm në grupe apo organizata tjera me fushëveprim të njëjtët për të mos dyfishuar punën.

Para vendimmarrjes për anëtarësim në trupat punuese duhet të sigurohet informacion në lidhje me pozicionin diplomatik të Kosovës në raport me palët e përfshira në aktivitetet e caktuara për të shmangur vështirësitë eventuale të pjesëmarrjes dhe përfaqësimit.

Për të minimizuar shpenzimet dhe mundësuar qasje më të lehtë dhe më të shpejtë rekomandohet që fillimisht të analizohen mundësitë e përfitimit në nivel regjional. Kjo nuk e përjashton mundësinë e prezantimit, promovimit dhe përfitimit të ZKA-së edhe në nivel global.

Departamenti për Komunikim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar formalisht bënë propozimin për anëtarësim apo kërkesën për tërheqje nga trupat punuese të mekanizmave ndërkombëtar.

Kjo bëhet në koordinim me Departamentin për Planifikim Strategjik dhe Raportim, Drejtorin e Përgjithshëm dhe zyrtarët tjerë përgjegjës.

3. VENDIMI PËR ANËTARËSIM DHE TËRHEQJE

3.1. Propozimin për anëtarësim nga ZKA

Propozimi për anëtarësim në një trupë punuese të caktuar duhet të bëhet në harmoni me qëllimet strategjike të ZKA-së, të përmbaj arsyetimin, të përshkruaj rëndësinë e pjesëmarrjes, përfitimet që ka ZKA-ja në një përfaqësim të tillë, burimet njerëzore që përfshihen dhe një analizë të kostos së mundshme financiare.

Të gjitha obligimet në kuadër të anëtarësisë duhet të integrohen në planin vjetor të punës dhe të jenë pjesë përbërëse e objektivave vjetore të zyrtarëve përgjegjës. Një plan i veçantë përgatitet për secilin grup, në të cilin do të paraqitet qëllimi, niveli i përgjegjësisë të pjesëmarrjes dhe çështje tjera që lidhen me detyrat dhe synimet për përfitim nga ZKA-ja.

Në rastet kur ka ndonjë nevojë urgjente për anëtarësim të ri në ndonjë nga trupat punuese apo identifikohen nevoja të reja, rekomandohet që pjesëmarrja të jetë në cilësinë e vëzhguesit derisa të krijohen kushtet dhe angazhimi të definohet përmes procedurës adekuate dhe të përfshihet në planin vjetor të punës.

3.2. Vendimi

Auditori i Përgjithshëm me vendim miraton anëtarësimin në një trup punuese në kuadër të INTOSAI, EUROSAI apo ndonjë organizate tjetër ndërkombëtare. Pjesëmarrja në aktivitete tjera (konferenca, punëtori, seminare etj.) bëhet me miratimin dhe sipas autorizimeve të AP-së.

3.3. Vendimi për tërheqje nga anëtarësimi

Në rast se vlerësohet se ka pushuar nevoja apo interesimi për të qenë anëtarë, Departamenti për Komunikim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar në Auditim në koordinim me zyrtarin përgjegjës për përfaqësim në trupën punuese të caktuar përgatitë një propozim për tërheqje i cili shqyrtohet nga AP.

Ky propozim duhet të përfshijë arsyet e tërheqjes dhe ndikimin e mundshëm në planin strategjik dhe objektivat e ZKA-së. Auditori i Përgjithshëm me vendim, aprovon apo refuzon tërheqjen nga anëtarësimi.

4. PËRFAQËSIMI

Përfaqësimi i ZKA-së do të bëhet përmes zyrtarit/ëve të caktuar nga cilido nivel hierarkik i ZKA-së, sipas vendimit të AP-së. Zyrtarët do të jenë ata të cilët janë të angazhuar në punën e përditshme me çështjet që ndërlidhen dhe trajtohen në kuadër të aktivitetit të caktuar.

Mbikëqyrësi përkatës, do të jetë përgjegjës për të menaxhuar dhe siguruar pjesëmarrjen aktive në aktivitete, ndërsa zyrtari pjesëmarrës merr obligime dhe siguron që përfaqësimi i ZKA-së do të jetë në pajtueshmëri me politikën dhe prioritetet e institucionit, duke siguruar njëkohësisht se përmes kësaj pjesëmarrjeje po arrihen përfitimet e pritura.

Nëse paraqitet nevoja, mbikëqyrësi përkatës vlerëson dhe i rekomandon AP-së marrjen e vendimit për zëvendësimin e zyrtarëve që përfaqësojnë ZKA-në në aktivitete afatgjata. Mbikëqyrësi përkatës duhet të siguroj se bartja e përgjegjësisë dhe të gjitha informatave bëhet në mënyrën e duhur nga zyrtari i mëparshëm tek zyrtari i ri.

Departamenti për Komunikim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtarë dhe zyrtarët tjerë sipas përgjegjësisë të deleguara nga AP, bëjnë përgatitjet për pjesëmarrje dhe përfaqësim të delegacioneve të ZKA-së në kongreset ndërkombëtare të INTOSAI dhe EUROSAI dhe ngjarje tjera të nivelit të lartë.

4.1. Përgjegjësitë dhe transferimi i njohurisë

Niveli i pjesëmarrjes dhe përgjegjësi në çdo aktivitet përcaktohet mbi bazën e planeve të punës, objektivave dhe programeve. Zyrtarët e ZKA-së të autorizuar nga AP, janë përgjegjës për të marrë pjesë në takime dhe për të kryer të gjitha detyrat e tjera në cilësinë e përfaqësuesit të ZKA-së.

Të gjitha detyrat duhet të regjistrohen dhe të raportohen tek mbikëqyrësi përkatës dhe të njoftohet Departamentit për Komunikim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar në Auditim, si dhe Kabineti i AP-së.

AP duhet të njoftohet (me raport pune) në baza të rregullta për progresin e arritur. Gjithashtu Departamenti për Komunikim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar në Auditim duhet të njoftohet rregullisht për planin e angazhimit dhe rezultatet e arritura.

Departamenti për Komunikim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar në baza vjetore harton raport për pjesëmarrjen e ZKA-së në aktivitete ndërkombëtare.

Njoftime të shkurtra përcjellë me fotografi, për pjesëmarrje në aktivitete duhet t'i dërgohen zyrtarit përgjegjës për komunikim me publikun për publikim të tyre në webfaqe dhe mediat sociale të ZKA-së.

Kur vlerësohet se në cilësinë e anëtarit ZKA-ja mund të marrë përgjegjësi të reja, por edhe të promovojë institucionin, zyrtari përgjegjës në koordinim me Departamentin për Komunikim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar në Auditim për këtë e njofton (raporton) AP-në dhe pas miratimit ndërmerr veprimet e duhura.

Pas çdo pjesëmarrje në aktivitete ndërkombëtare duhet të raportohet me shkrim (formati në shtojcë).

Njohuria dhe praktikat e mira të përfituara gjatë pjesëmarrjes në aktivitete të bashkëpunimit ndërkombëtar, mund të ndahen me kolegët në zyre që kanë interesim.

5. BUXHETI

Me rastin e përgatitjes së kërkesës buxhetore të ZKA-së do të merren parasysh edhe shpenzimet për nevoja të pjesëmarrjes në aktivitetet ndërkombëtare.

Si anëtarë me të drejta të plota në INTOSAI dhe EUROSAI, ZKA-ja merr përsipër pagesën e anëtarësisë vjetore sipas tarifave të përcaktuara nga këto organizata. Departamenti për Komunikim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar në Auditim duhet të njoftoj me kohë Departamentin për Buxhet dhe Financa për të ekzekutuar pagesën brenda afatit kohor të përcaktuar.

Personat përgjegjës (çaktuar me vendim të AP-së) për përfaqësim, njoftojnë me kohë Drejtorin e Përgjithshëm dhe dep. për Buxhet dhe Financa si dhe Departamentin për Komunikim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar në Auditim për Planin e Punës së aktiviteteve ku është pjesëmarrës dhe shpenzimet e parashikuara sipas angazhimit.

Për pjesëmarrje në aktivitete tjera të njëhershme bëhet një parashikim financiar i përafërt. ZKA-ja duhet të ketë në dispozicion një fond rezervë për përfaqësim në aktivitete të pa planifikuara, por me interes për ZKA-në.

ZKA-ja, më aprovim paraprak nga AP mund të marrë përsipër të jetë organizator i ndonjë prej aktiviteteve në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar. Kjo mund të bëhet, me konfirmim paraprak të disponueshmërisë së mjeteve nga Drejtori i Përgjithshëm.

6. NDIKIMI DHE NDRYSHIMI

ZKA-ja pret që angazhimi i zyrtarëve në aktivitetet ndërkombëtare t'i sjell institucionit përfitime në rritjen e njohurisë dhe praktikës së mirë si dhe shkëmbimin e përvojave me kolegë nga institucionet tjera supreme të auditimit.

Përmes angazhimeve të tilla synon të rrisë rolin e ZKA-së dhe të promovojë institucionin në organizatat ndërkombëtare. Angazhimi duhet të shërbejë edhe për rritje dhe shkëmbime profesionale me ISA-t tjera.

7. PROCEDURA PËR REALIZIM DHE PJESËMARRJE NË AKTIVITETE NDËRKOMBËTARE

Kërkesa për pjesëmarrje duhet të bëhet së paku pesë (15) ditë para datës së udhëtimit.

Përgjatimisht këtij afatit, kërkesa mund të dorëzohet në afat më të shkurtë se pesë (15) ditë në raste të veçanta dhe të jashtëzakonshme.

I punësuarit që do të realizojë udhëtimin zyrtar, kërkesën e bën duke ndjekur procedurën si në vijim:

1. Plotësohet formulari i kërkesës për udhëtim zyrtar jashtë vendit;
2. Formulari i kërkesës duhet të miratohet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë dhe pas miratimit duhet t'i dërgohet Departamentit për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore;
3. Konfirmimin për mjete buxhetore nga Departamenti për Buxhet dhe Financa;
4. Departamenti për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, pas verifikimit të të dhënave, kërkesën e dorëzon tek AP për miratim;
5. Pas miratimit nga AP kërkesa dërgohet tek Departamenti për Buxhet dhe Financa për ekzekutim.

Asnjë udhëtim zyrtar nuk mund të realizohet pa miratim paraprak nga AP.

8. NDRYSHIMI, RISHIKIMI DHE PLOTËSIMI

Ky udhëzues mund të ndryshohet, rishikohet dhe plotësohet në përputhje me rrethanat dhe kërkesat në mënyrën e njejtë siç është aprovuar.

9. HYRJA NË FUQI

Ky udhëzues hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Auditorja e Përgjithshme.

14.04.2025

Vlora SPANCA

Auditore e Përgjithshme

SHTOJCAT:

ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE DHE REGJIONALE

- I. ORGANIZATA NDËRKOMBËTARE E INSTITUCIONEVE SUPREME TË AUDITIMIT (INTOSA) – ANËTARE ME TË DREJTA TË PLOTA
- II. ORGANIZATA EVROPIANE E INSTITUCIONEVE SUPREME TË AUDITIMIT – ANËTARE ME TË DREJTA TË PLOTA
- III. RRJETI I INSTITUCIONEVE SUPREME TË AUDITIMIT, KANDIDATE DHE KANDIDATE TË MUNDSHME PËR ANËTARËSIM NË BE - VËZHGUES

FORMULARËT E KËRKESAVE DHE RAPORTIMIT

- I. FORMULARI I KËRKESËS PËR ANËTARËSIM/TËRHEQJE NË TRUPAT PUNUESE NDËRKOMBËTARE VENDIMI PËR ANËTARËSIM/TËRHEQJE
- II. FORMATI ZYRTAR PËR RAPORTIM
- III. KËRKESA PËR UDHËTIM ZYRTAR JASHTË VENDIT